Kronikë

Fier/ 40-vjeçari plagoset me pistoletë nga i dashuri i gruas, rëndë në spital, sherri në sy të fëmijës 9 vjeç

Një 40-vjeçar në Fier, i cili është në proces divorci me bashkëshorten është plagosur nga i dashuri i kësaj të fundit pas mosmarrëveshjeve për kujdestarinë e fëmijës. Ngjarja e rëndë kriminale ka ndodhur në syrë e fëmijës, i cili sot ka mamanë në arrati dhe babanë në gjendje të rëndë për jetën. Avokati Ermal Hamataj ka treguar ngjarjen për 'Report TV'

HOROSKOPI

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

Marsela Topi
10 Janar, 15:40 | **Përditësimi: 10 Janar, 20:59**

Share

Fier - Një fëmijë vetëm 9-vjeç në Fier ka mbetur pa kujdesin e prindërve. Mamaja e tij u arratis me bashkëjetuesin, ndërsa i ati është në spitalin e Traumës në gjendje të rëndë për jetën.

Babai i fëmijës, Gledian Hoxhallari u plagos mbrëmjen e së dielës (5 janar) në një lokal tek 'Zogu i Zi' në Fier, ndërsa në kërkim është shpallur autori i dyshuar, Klement Beqaj dhe mamaja e fëmijës, Melisa Beluli.

Ngjarja kriminale

[Sh.com]

LEXO EDHE:
'Krizë' për mjekë në spitalin e Fierit! Shefi i Urgjencës: Nuk po ia dalim dot me 140 vizita në ditë, na ndihmojnë mjekët e familjes

40-vjeçari, me profesion kameraman, gjendej në lokal me të birin 9-vjeç në pritje për të takuar bashkëshorten *(vetem me letra)* pasi ata prej 3 muajsh nuk jetonin bashkë dhe ishin në proces divorci. Kjo e fundit u paraqit në lokal bashkë me të dashurin, 25-vjeçarin Klement Beqaj dhe aty kanë debatuar të tre për kujdestarinë e fëmijës. Beqaj ka nxjerrë pistoletën dhe ka qëlluar 40 vjeçarin, duke e lënë të plagosur rëndë.

E gjithë skena është zhvilluar në sytë e fëmijës 9-vjeç. Mamaja e tij, 29-vjecarja Melisa Beluli sot ndodhet në kërkim policor për moskallëzim krimi bashkë me autorin e krimit, Klement Beqaj, síç bën të ditur policia e Fierit.

Martesa e dështuar

Përfaqësuesi ligjor i të plagosurit, avokati Ermal Hamataj ka treguar për Report Tv se vetëm një javë më parë, Gjykata e Fierit ka lëshuar urdhër mbrojtje për gruan, e cila kishte deklaruar se ndihej e kërcënuar nga bashkëshorti. Në urdhërin e mbrojtjes, Gjykata kishte vendosur që kujdestaria të ushtrohej nga të dy prindërit deri në përfundim të procesit gjyqësor për zgjidhjen e martesës.

Ditën e ngjarjes (5 Janar), Glediani i ka telefonuar gruas që të shkonte të merrte fëmijën, sipas grafikut të caktuar nga Gjykata, por ajo është paraqitur në lokal bashkë me të dashurin. Të tre kanë debatuar dhe më pas Beqaj ka qëlluar me pistoletë 40 vjeçarin, me një plumb në bark.

Ajo çfarë e bën më të rëndë është fakti se ngjarja ka ndodhur në sy të fëmijës 9-vjeç, i cili aktualisht qendron me gjyshërit në gjendje të rënduar psikologjike. 'Kjo është një papërgjegjshmëri amësore e paprecedentë',- tha avokati Hamataj – 'dhe do bëjmë gjithçka që mamasë t'i hiqet kujdestaria e të birit'.

Njoftimi i policisë së Fierit

Në vijim të informacionit të datës 05.01.2025, mbi plagosjen me armë zjarri të shtetasit G. H., 40 vjeç, në vendin e quajtur "Kryqëzimi i Zogut të Zi", sqarojmë se si rezultat i veprimeve hetimore u bë shpallja në kërkim e shtetases M. H., 29 vjeçe (bashkëshortja e 40-vjeçarit, me të cilën është në proces për zgjidhjen e martesës). Vijon puna për lokalizimin dhe kapjen e saj, si dhe të autorit të plagosjes, shtetasit K. B., 26 vjeç.

Më datë 08.01.2024, për këta shtetas, Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Fier ka caktuar masën e sigurisë "Arrest në burg", përkatësisht për shtetasin K. B., për veprat penale "Vrasja me dashje", mbetur në tentativë dhe "Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve dhe municionit luftarak", ndërsa për shtetasen M. H., për veprën penale "Moskallëzimi i krimit". Materialet procedurale i kaluan Prokurorisë së Fierit, për veprime të mëtejshme.

R.D/A.Q/Shqiptarja.com

TAG: Gledian Hoxhallari | Klement Beqaj | divorci | plagosje | Fier | Melisa Beluli

Komentoj

Komente

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

SH.COM

Sondazhi i ditës: 10 Janar, 11:51
A duhet të çojë SPAK Berishën përpara Gjykatës për masakrën e 21 janarit?

Po | Jo | Nuk e di

Lajme të tjera

Lushnjë/ Kanabis, kokainë dhe eksploziv, 3 të arrestuar, një 17-vjeçar nën hetim (EMRAT)
9 Janar, 13:07

Fier/ Drogë, aksident, përndjekje dhe dhunë në familje, 8 persona nën hetim
7 Janar, 15:26

Festohet Dita e Ujit të Bekuar, ortodoksët në të gjithë vendin kryejnë ritin e hedhjes së kryqit në ujë! Në Gjirokastër 13- vjeçari i vetëm në garë
6 Janar, 08:33

Fier/ Plagosje me armë zjarri te 'Kryqëzimi i Zogut të Zi', policia në ndjekje të autorit
5 Janar, 21:54

Gjysma e Shqipërisë në 'black-out' për 1 orë! Burime për Report Tv: Ra linja e transmetimit 220 kv Kashar-Rrashbull (VIDEO)
5 Janar, 17:44

Nga sot Thumanë-Kashar me pagesë! Nga 250 - 870 Lekë, ja tarifat për çdo kategori mjetë! Sa do paguhet për hyrje daljet në aeroportin e Rinasit
4 Janar, 09:06

Fier/ Makinat përplasen 'kokë më kokë', plagoset një nga shoferët! (VIDEO)
Marsela Topi
3 Janar, 10:52

Fier/ Aksidente dhe dhunë në familje, 3 të arrestuar, 4 nën hetim e një në kërkim! 34-vjeçarja hidhet nga ballkoni prej frikës, bashkëjetuesi e kërcënoi me thikë
3 Janar, 10:13

Autoboti pret rrugën në Fier-Levan, 3 të plagosur në aksident nga përplasja e tre mjeteve! (VIDEO)
2 Janar, 12:06

Zjarrfikësit shpëtojnë nga djegia totale banesën në Ballsh, shkak i flakëve ishte kalorifери
31 Dhjetor 2024, 16:18

Tregu mbushet me produkte të ngrira, gjelat e detit u mbetën në 'derë' fermerëve të Fierit: Do t'i hamë vetë, nuk i shesim nën kosto
Marsela Topi
31 Dhjetor 2024, 15:48

Aksident në autostradën Lushnje Fier, përplasen 3 mjete, shkaktohet radhë e gjatë trafiku
31 Dhjetor 2024, 14:13

© 2011 - 2025 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje